

Fletë udhëzuese e paketimit: Informacion për përdoruesin

Gripoflex 500

Pluhur për tretësirë për përdorim nga goja

paracetamol
feniraminë maleat
acid askorbik

Lexoni me kujdes gjithë fletën udhëzuese përpara se të përdorni këtë bar, pasi përmban informacion të rëndësishëm për ju.

Ky produkt mjekësor mund të merret pa recetë. Megjithatë, me qëllim që të merrni rezultatet më të mira, është e nevojshme që ta përdorni këtë produkt me kujdes.

- Ruajeni këtë fletë udhëzuese. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri atë.
- Në rast se keni pyetje të tjera, drejtohuni farmacistit.
- Këshillohuni me mjekun në rast se pas 3 ditësh trajtim simptomat nuk përmirësohen ose përkeqësohen.
- Në rast se ju shfaqet ndonjë efekt i padëshiruar këshillohuni me mjekun ose farmacistin. Kjo vlen edhe në rast se ju shfaqen efektet e padëshiruara që nuk janë përshkruar në këtë fletë udhëzuese

Çfarë mund të gjeni në këtë fletë udhëzuese:

1. Çfarë është Gripoflex 500 dhe për çfarë përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni Gripoflex 500
3. Si përdoret Gripoflex 500
4. Efektet e padëshiruara të mundshme
5. Si ruhet Gripoflex 500
6. Përmbajtja e paketimit dhe të dhëna të tjera

1. Çfarë është Gripoflex 500 dhe për çfarë përdoret

Gripoflex 500 paraqitet si një kombinim barnash me veprim analgjezik (qetëson dhimbjet) dhe antipiretik (ul temperaturën trupore të rritur). Ky produkt përmban 3 lëndë vepruese: paracetamol, acid askorbik (vitaminë C) dhe feniraminë maleat (më tej do të referohet thjesht feniraminë).

Gripoflex 500 mund të përdoret për të qetësuar simptomat e të ftohurit të zakonshëm, gripit dhe inflamacioneve të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes, përfshi dhimbjet e kokës, dhimbjet e trupit, ethe, kongjestionin e hundëve dhe sinuseve (zënie e hundëve), rhinitin (rrjedhjen e hundëve) dhe teshtimat.

2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni Gripoflex 500

Mos përdorni Gripoflex 500

- në rast se jeni alergjik ndaj ndonjë prej lëndëve vepruese ose ndaj ndonjë prej përbërësve të tjerë (ingredientëve) të këtij produkti mjekësor (të shënuar në paragrafin 6)

- në rast se vuani nga presioni i lartë i gjakut (hipertensioni arterial)
- në rast se vuani nga glaukoma me kënd të mbyllur
- në rast se vuani nga probleme të formës së rëndë të mëlçisë, veshkave, zemrës dhe enëve të gjakut, gjëndrës tiroide ose mushkërive (përfshi astmën bronkiale)
- në rast se vuani nga ulcera e stomakut ose e zorrëve të holla (duodenit)
- në rast se vuani nga semundje të pankreasit ose të fshikëzës së urinës
- në rast se jeni një mashkull që vuani nga probleme të prostatës (adenoma e prostatës e cila shkakton urinë reziduale)
- në rast se vuani nga çrregullime hematopoetike (të formimit të gjakut)
- në rast se vuani nga një gjendje e rrallë, e trashëguar, e njohur si pamjaftueshmëria e glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës (çrregullime të qelizave të kuqe të gjakut)
- në rast se jeni shtatzënë ose jeni duke ushqyer foshnjën me qumështin e gjirit tuaj

Ky produkt mjekësor nuk duhet të përdoret nga fëmijët dhe të rinjtë me moshë nën 15 vjeç.

Ky produkt mjekësor nuk këshillohet të përdoret në rast se vuani nga gjendje ku aftësia e gjakut për tu mpiksuar është e shtuar.

Mos përdorni produkte mjekësore të tjera që gjithashtu përmbajnë paracetamol dhe/ose feniraminë maleat, barna antiinflamatorë jo steroidë, barna që veprojnë në sistemin nervor qendror (SNQ) (hipnotikë, sedativë, antidepressantë triciklikë) ose antihipertensivë (p.sh. β bllokues).

Paralajmërimet dhe përkujdesjet

Mos tejkaloni dozën e këshilluar!

Këshillohuni me mjekun në rast se simptomat tuaja, të tilla si dhimbja dhe rritja e temperaturës së trupit, vazhdojnë për më shumë se 3 ditë ose në rast se ju shfaqen simptoma të reja, si p.sh. skuqja dhe ënjtja e fytit.

Tregoni kujdes të veçantë në rast se vuani nga probleme të mëlçisë ose veshkave (kur këto probleme janë të formave të rënda Gripoflex 500 është i kundëriindikuar), çrregullime hematopoetike (të formimit të gjakut) ose në rast se jeni mbi 65 vjeç.

Nderprisni përdorimin e mëtejshëm të Gripoflex 500 dhe shkoni menjëherë te mjeku në rast se ju shfaqen të përziera, të vjella, dhimbje barku, humbje të oreksit, gjendje e sëmurë, marrje mendsh, nervozizëm i theksuar, zhurmë në vesh apo çrregullime të dëgjimit.

Në rast se keni konsumuar shumë alkool, këshillohuni me mjekun përpara se të përdorni Gripoflex 500.

Përdorimi i barnave të tjerë dhe Gripoflex 500

Jeni të lutur të njoftoni mjekun ose farmacistin në rast se jeni duke përdorur ose para pak kohësh keni përdorur barna të tjerë, përfshi edhe barnat që merren pa recetë.

- Mos përdorni produkte mjekësore të tjera që gjithashtu përmbajnë paracetamol dhe/ose feniraminë maleat, barna antiinflamatorë jo steroidë, barna që veprojnë në sistemin nervor qendror (SNQ) (hipnotikë, sedativë, antidepressantë triciklikë) ose antihipertensivë (p.sh. β bllokues).
- Përdorimi i njëkohshëm i Gripoflex 500 dhe barbiturateve, fenitoinës, karbamazepinës, rifampicinës, dhe barnave të tjerë nxitës të enzimave mikrozomale të

mëlçisë rrit rrezikun e shfaqjes së hepatotoksicitetit (dëmtimit të mëlçisë) të shkaktuar nga paracetamoli.

- Përdorimi i njëkohshëm i zidovudinës dhe paracetamolit mund të shtojë toksicitetin e të dy këtyre barnave; granulocitopenia (pakesim i numrit të qelizave të bardha të gjakut) vërehet më shpesh.
- Acidi askorbik shton përthithjen e penicilinave, pakeson efikasitetin e heparinës dhe antikoagulantëve oralë, rrit rrezikun për kristaluri, në rast se përdoret njëkohësisht me salicilatet.

Në rast se keni ndonjë pyetje të mëtejshme për përdorimin e këtij produkti mjekësor, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

Përdorimi i Gripoflex 500 me ushqimin, lëngjet dhe alkoolin

Gjatë trajtimit me këtë bar duhet të shmangët konsumi i alkoolit (p.sh. birrës, verës dhe pijeve alkoolike) pasi efekti i alkoolit mund të fuqizohet. Alkooli gjithashtu mund të nxisë shfaqjen e efekteve të padëshiruara të paracetamolit dhe/ose të pankreatitit akut.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji

Këshillohuni me mjekun përpara se të përdorni çdo lloj bari.

Mos përdorni Gripoflex 500 gjatë shtatzënisë dhe në periudhën e ushqyerjes së fëmijës.

Drejtimi i automjeteve dhe përdorimi i makinerive

Mos drejtoni automjete dhe mos përdorni makineri në rast se jeni duke përdorur Gripoflex 500. Ky produkt mjekësor mund të shkaktojë marrje mendsh dhe lodhje.

Të dhëna të rëndësishme për disa nga lëndët përbërëse të Gripoflex 500

Ky produkt mjekësor përmban aspartam (burim i fenilalaninës), i cili mund të jetë i dëmshëm për njerëzit që vuajnë nga fenilketonuria.

Ky produkt mjekësor përmban lëndën ngjyrosëse “e verdhë e perëndimit” (E110), e cila mund të shkaktojë reaksione alergjike.

3. Si përdoret Gripoflex 500

Trajtimi me Gripoflex 500 duhet të fillohet menjëherë sapo të vëreni shfaqjen e simptomave të para të sëmundjes.

Përmbajtja e një qeske tretetet në një gotë me ujë të nxehtë dhe pihet kur lëngu të jetë i ngrohtë.

Të rriturit dhe të rinjtë me moshë mbi 15 vjeç: një qeskë tre herë në ditë, duke i ndarë dozat nga njëra tjetra nga një periudhë të paktën 4 orë. Në rast se vuani nga sëmundje të veshkave Gripoflex 500 duhet të merret me intervale kohore ndërmjet dozave jo më të shkurtëra se 8 orë.

Mos përdorni më shumë se 3 qeska përgjatë 24 orëve!

Në rast se merrni më shumë Gripoflex 500 nga sa nevojitet

Mbidozimi me paracetamol mund të jetë i rrezikshëm. Kërkoni menjëherë ndihmën mjekësore edhe në rast se për momentin ndjeheni mirë, për shkak të rrezikut të pasojave

serioze, të më vonshme, të mbidozimit. Simptomat janë të përziera dhe të vjella, dhimbje stomaku ose barku, humbje të oreksit, marrje mendsh, zhurmë në vesh, çrregullime të dëgjimit (sidomos në pacientët e moshuar), gjendje e sëmurë.

Në rast se harroni të merrni Gripoflex 500

Në asnjë rast mos dyfishoni dozën me qëllim që të kompensoni dozën e harruar.

4. Efektet e padëshiruara të mundshme

Si të gjithë barnat, edhe Gripoflex 500 mund të shkaktojë efekte të padëshiruara, ndonëse ato nuk shfaqen tek të gjithë personat që e përdorin atë.

Shpeshësia me të cilën mund të shfaqen efektet e padëshiruara është kategorizuar si më poshtë:

- shumë të zakonshme: shfaqen në më shumë se 1 ndër 10 përdorues
- të zakonshme: shfaqen në 1 deri 10 ndër 100 përdorues
- jo të zakonshme: shfaqen në 1 deri 10 ndër 1.000 përdorues
- të rralla: shfaqen në 1 deri 10 ndër 10.000 përdorues
- shumë të rralla: shfaqen në më pak se 1 ndër 10.000 përdorues

Jo të zakonshme: tharje goje, dhimbje stomaku, diarre, të përziera

Të rralla: ngadalësim i përgjigjes ndaj stimujve, marrje mendsh, dhimbje koke, konfuzion në pacientët e moshuar, çrregullime të akomodimit të shikimit (dëmtim i aftësisë së syrit për të fokusuar objektet), takikardi (rrahje të shpejta të zemrës), hipertension i përkohshëm (rritje të presionit të gjakut), skuqje të lëkurës (rash), të kruara, urtikarie, edemë Quincke (ënjtje të fytyrës me natyrë alergjike), vështirësi gjatë urinimit

Shumë të rralla: anemi, leukopeni, trombocitopeni, agranulocitozë, met'hemoglobinemi

Në rast se ju shfaqet ndonjë efekt i padëshiruar këshillohuni me mjekun ose farmacistin. Kjo vlen edhe në rast se ju shfaqen efektete të padëshiruara që nuk janë përshkruar në këtë fletë udhëzuese.

5. Si ruhet Gripoflex 500

Të mbahet në vende me temperaturë nën 25°C. Të mbrohet nga lagështia.

Të ruhet në vende që nuk mund të shihen dhe të arrihen nga fëmijët.

Mos e përdorni këtë produkt mjekësor pas datës së skadencës të shënuar në blister dhe paketim. Data e skadencës nënkupton ditën e fundit të muajit të shënuar.

6. Përmbajtja e paketimit dhe të dhëna të tjera

Çfarë përmban Gripoflex 500

Lëndët vepruese janë: paracetamol 500 mg
acid askorbik 200 mg
feniraminë maleat 25 mg

lëndë të tjera jo vepruese (ekscipientë) janë: aspartam, manitol, lëndë aromatike, lëndë ngjyruese “e verdhë e perëndimit FCF” (E110).

Si paraqitet Gripoflex 500 dhe përmbajtja e paketimit

Pluhur me ngjyrë të bardhë-rozë në rozë. Prania e grimcave me ngjyrë të verdhë ose portokalli është e lejuar.

Çdo kuti kartoni përmban 5 qeska dhe një fletë udhëzuese.

Zotërues i Lejes së Tregëtimit dhe Prodhues

JSC Olainfarm.

Address: 5, Rupnicu St., Olaine, LV-2114, Letoni.

Phone +371 67013701 • Fax +371 67013777 • e-mail: olainfarm@olainfarm.lv

Kjo fletë udhëzuese është miratuar për herë të fundit më: 11.2011